




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, nenit 4 dhe 8 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019, duke vendosur sipas kërkesës Nr.1-400-29168 të datës 01.06.2021 së Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së dega në Lipjani, Kryetari i Komunes, nxjerr:

VENDIM
PËR MBËSHTETJE FINANCIARE

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej 500 € (pesëqind euro) Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së dega në Lipjani sipas kërkesës të tyre Nr.1-400-29168 të datës 01.06.2021 për ta mbështetur financiarisht për zhvillimin e veprimtarisë së organizatës së tyre për vitin 2021.

Neni 2

Shuma e çekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2021, pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport në xhirollogarinë bankare të Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së në nr. 1110270777000187 në ProCredit Bankë..

Neni 3

Lidhur me mjetet e shpenzuara, Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së dega në Lipjani duhet të sjellë raport narrativ dhe financiar duke i bashkëngjitur faturat të cilat dorëzohen në Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport më së largu deri me 25.12.2021.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së dega në Lipjani.

1Nr. 453-29168
Lipjan, më 02.06.2021

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

